



ANALIZË E POLITIKAVE

Nr. 2/16 – Mars 2016

**REAGIMI NDAJ PASTRIMIT TË PARAVE
NË KOSOVË:
NË MES TË POLITIKAVE DHE PRAKTIKËS**

Ky Projekt mbështetet nga Komisioni Evropian, Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë.



Përmbajtja dhe pikëpamjet e shprehura në këtë publikim i takojnë KIPRED-it dhe nuk duhet të konsiderohen si pikëpamjet e Komisionit Evropian, Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë.

Përpiluar nga: Ariana Qosaj-Mustafa dhe Violeta Haxholli

Hulumtimi është i mbështetur nga: Njomza Sejdullahu dhe Vlora Gaxherri

E drejta autoriale © 2016 KIPRED. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem ruajtës apo të transmetohet në ndonjë formë apo me anë të ndonjë mjeti, qoftë elektronik, mekanik, fotokopjim, incizues apo të tjera, pa lejen paraprake të publikuesit. Luteni të kontaktoni info@kipred.org apo +381 38 227 778.

Publikuar nga:



Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave
Rruga Abdyl Frashëri, Nr.44
10 000 Prishtinë, Kosovë
Tel +381 38 227 778
www.kipred.org



Syri i Vizionit
Isa Demaj, Nr. 14 30000
Pejë, Kosovo
Tel. +381 (0) 39 423 240
www.syriivizionit.org

Përmbajtja

I. Pasqyra Aktuale mbi Aktivitetet e Pastrimit të Parave.....	3
II. Kërkesat e BE-së për Kosovën në Luftimin e Pastrimit të Parave	5
III. Korniza Ligjore për Luftimin e Pastrimit të Parave	6
IV. Reagimi me Hetime, Ndjekje dhe Dënime të Krimeve që ndërlidhen me Pastrimin e Parave....	10
a) Ndjekja penale e krimit të pastrimit të parave.....	11
b) Reagimi i gjyqësorit	15
c) Roli i institucioneve të tjera në hetimin e krimeve të pastrimit të parave	18
d) Përpjekjet e koordinimit në luftën kundër pastrimit të parave	20
V. Përfundim dhe Rekomandime.....	23
VI. Shtojca.....	26

I. Pasqyra Aktuale mbi Aktivitetet e Pastrimit të Parave

Dukuria e pastrimit të parave në Kosovë konsiderohet të jetë e përhapur, me përgjigjen e institucioneve shtetërore të Kosovës në fazat fillestare të saj. Shumat nga krimet e korrupsionit, kundërvajtja fiskale, duke përfshirë evazionin fiskal, për krime që lidhen me prokurimin dhe procesin e privatizimit dhe krime të tjera financiare, janë krime më të zakonshme të pastrimit të parave në Kosovë.¹ Të ardhurat tjera duke përfshirë aktivitetet e kontrabandës besohet të pastrohen drejtpërdrejtë në ekonominë e shtetit, në fushat si: ndërtimi dhe pasuritë e patundshme, organizmat tregtare dhe ato me pakicë, bankat, shërbimet financiare, kazinotë dhe kompanitë tregtare.² Shuma të konsiderueshme të parave janë të investuara në pasuri të patundshme, restorante, bare dhe lojëra të fatit siç janë: kazinotë, makinat me monedha dhe objekteve të basteve sportive.³ Përveç kësaj, ekonomia joformale në Kosovë ka ushqyer një ambient të përshtatshëm për fenomenin e pastrimit të parave. Shkalla e ekonomisë joformale në Kosovë llogaritet të radhitet nga 26% deri në 35% të PBB-së totale.⁴ Në një analizë të kryer në vitin 2013, menaxherët e biznesit dhe pronarët besojnë se mesatarisht bizneset në industrinë e tyre raportojnë rreth 65.6% të shitjeve të tyre, që do të thotë se 34.4% të tyre e shmangin.⁵ Kapacitetet institucionale të Kosovës janë të kufizuara që t'i mbikëqyrin këto lëvizje të ekonomisë joformale dhe gjithashtu legalizimin e parave.

Strategjia e Qeverisë së Kosovës (QK) e realizuar në vitin 2013, tregoi se pastrimi i parave, financimi i terrorizmit dhe të krimeve të tjera ekonomike dhe financiare janë krime që vështirë mund të zbulohen. Në vitin 2013, është bërë vetëm vlerësimi i parë i rrezikut kombëtar nga Q.K. për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit. Megjithatë, dokumenti nuk është bërë publik⁶ dhe në mesin e arsyeve të cituara ka qenë të mos frikësojnë investitorët potencialë jashtë Kosovës.⁷ Mandej, Njësia e Inteligjencës Financiare të Kosovës (NJIF), në vitin 2013, botoi për herë të parë një studim lidhur me tipologjitë e pastrimit të parave dhe financimit të akteve të terrorizmit në Kosovë.⁸ Ky raport thekson se format e pastrimit të parave në Kosovë janë zakonisht të ndërlidhura me

¹ Ministria e Financave e Republikës së Kosovës "Strategjia kombëtare e Republikës së Kosovës për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve financiare 2014-2018," fq.7. I disponueshëm në: <https://mf.rks-gov.net/sq-al/Strategjia-Kombetare>

² Departamenti i Shtetit të Shteteve të Bashkuara (US DS), Byroja Ndërkombëtare e Narkotikëve dhe Çështjet e Zbatimit të Ligjit, Baza e të Dhënave e Shtetit për Pastrimin e Parave dhe Krimet Financiar, qershor 2015, fq.247. I disponueshëm në: <http://www.state.gov/documents/organization/239329.pdf>

³ Shih fq.30 të Këshillit të Evropës, Projekt kundër Krimeve Ekonomike (PECK) "Raporti i Vlerësimit në përputhje me standardet ndërkombëtare në fushën e pastrimit të parave dhe luftën kundër financimit të terrorizmit (AML/CFT)," publikuar në dhjetor 2014.

I disponueshëm në: http://www.psh-ks.net/repository/docs/AML_ENG_WEB.pdf

⁴ Shih Ministria e Financave e Republikës së Kosovës "Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për parandalimin dhe luftën kundër ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare 2014-2018", fq.25.

⁵ Institutu RIINVEST, "Të paguash apo të mos paguash: Një Perspektivë e Biznesit të Informalitetit në Kosovë, f. 15. Shih në

http://www.fesprishtina.org/wb/media/Publications/2013/BUSINESS_INFORMALITY_ENG_FINAL.pdf

⁶ KIPRED dërgoi një kërkesë te Ministria e Financave në mars 2016 për qasje në dokument por Ministria nuk e ka siguruar deri më tash këtë dokument për KIPRED.

⁷ Intervista e KIPRED me NJIF, Prishtina, shtator 2014.

⁸ Njësia Inteligjente Financiare e Kosovës (NJIF), "Tipologjitë e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit në Republikën e Kosovës". I disponueshëm; <http://fiu.rks-gov.net/ep-content/uploads/2014/10/Typology-Eng1.pdf>

përdorimin e sistemit bankar duke huazuar para nëpërmjet kredive bankare për të arsyetuar origjinën e fondeve, transferimin e fondeve tek shtetet e njohura për trafikim të drogës në Ballkan pa specifikuar shtetet e përfshira dhe duke përdorur transfere ndërkombëtare të fondeve jashtë Kosovës dukë përfshirë rastet e trafikimit të qenieve njerëzore dhe formave tjera të krimit të organizuar. Format tjera që ndërlidhen me pastrimin e parave është përdorimi i transaksioneve të shumave të mëdha të parave duke krahasuar aktivitetin afarist të mbajtësit të llogarisë, fondeve investuese në pasuri të paluajtshme dhe duke zhvendosur fondet në mes të disa kompanive me pronarin e njëjtë dhe integrimin e shitjes nga asetet përmes përdorimit të kompanive të sigurimit me të njëjtit pronarë d.m.th. përdorimit të kompanive ndërtimore.⁹ Tendenca e përgjithshme në raste të pastrimit të parave është të kryen transaksione biznesi në llogaritë private pa pasur biznese të regjistruara.¹⁰

Fusha e ndërtimitarisë në veçanti, ka ofruar një ambient të përshtatshëm për zhvillimin e veprimtarive të mundshme të pastrimit të parave në Kosovë. Investimet e lidhura me ndërtimin në Kosovë kanë qenë të udhëhequra në mënyrë të dyshimtë nga ana e investitorëve jo të kualifikuar në punën e ndërtimitarisë shpesh duke mos ditur origjinën e parave të investuara. Pas vitit 1999 Kosova iu nënshtrua aktivitetit të konsiderueshëm të ndërtimit të paligjshëm. Është vlerësuar se ka mbi 350.000 ndërtime pa leje në tërë Kosovën me 46.000 ndërtime pa leje të raportuara vetëm në Komunën e Prishtinës.¹¹ Në veçanti, aktivitetet e dyshimta të pastrimit të parave janë shfaqur gjatë periudhës 1999-2000. Identifikimi i aktiviteteve të paligjshme të ndërtimit është dukur i vështirë gjersa sasi e madhe e kapitalit ishte akumuluar dhe është përdorur në mënyrë të pa monitoruar pasi paraja ka qarkulluar në mungesë të një sistemi bankar funksional.¹² Prokuroria vazhdon të justifikon mungesën e përgjigjes për shkak se mjetet monetare kanë qarkulluar gjatë kësaj periudhe.¹³ Origjina e pasurisë së përlllogaritur dhe të pastruar duke përfshirë pasurimin e pashpjegueshëm gjatë kësaj periudhe mbetet e panjohur deri më tani. Pasuria e pashpjegueshme dhe origjina e pasurive të deklaruara nga zyrtarët e lartë publikë e raportuar në baza vjetore është duke treguar rritje të pashpjegueshme përgjatë viteve që nuk përputhen me të ardhurat e tyre vjetore, por vazhdojnë të mos hetohen për shkak të reagimit të dobët të institucioneve të sundimit të ligjit në këtë drejtim.

Për më tepër, partitë politike vazhdojnë të mos raportojnë rregullisht te Njësia e Inteligjencës Financiare të Kosovës,¹⁴ përderisa kompanitë më të fuqishme të vendit mbesin ngushtë të ndërlidhura me partitë politike dhe vazhdojnë të marrin tenderë dhe fonde në formë të tenderëve publike. Është përlllogaritur se nga gushti 2007 deri më maj 2014 disa donatorë të partive politike në

⁹ Ibid, fq.19.

¹⁰ Shih fq.30-30 të Këshillit të Evropës, Projekti kundër Krimit Ekonomik (PECK) “Raporti i Vlerësimit në përputhje me standardet ndërkombëtare në fushën e pastrimit të parave dhe luftën kundër financimit të terrorizmit (AML/CFT),” e publikuar dhjetor 2014.

I disponueshëm në :http://www.psh-ks.net/repository/docs/AML_ENG_WEB.pdf

¹¹ Komuna e Prishtinës, Raporti Vjetor 2015, fq.3. I disponueshëm në, <https://kk.rks-gov.net/prishtina/getattachment/Municipality/President/President-Report/raporti-2015.pdf.aspx>

¹² Intervista e KIPRED me zyrtarë të NJIF, Prishtinë, shtator 2014.

¹³ Deklarata e zyrtarit të Prokurorit të Shtetit nga Gjakova nga Prokuroria Themelore, në tryezën e rrumbullakët të organizuar nga KIPRED dhe Syri i Vizionit, më 31 mars 2016 në Prishtinë.

¹⁴ Shih raportin vjetor të NJIF, qershor 2015 fq.19.

pushtet – entitete afariste dhe pronarë – kanë përfituar rreth 220 milion Euro në formë të tenderëve publik.¹⁵ Ky rreth i egër vazhdon të dobëson sundimin e mëtejshëm të ligjit në Kosovë, duke bërë që sasi të mëdha të aktiviteteve të pastrimit të parave në Kosovë rrallë të hetohen ose dënohen siç do të tregohet nga analiza më poshtë.

II. Kërkesat e BE-së për Kosovën në Luftimin e Pastrimit të Parave

BE-ja vazhdon të kërkojë nga institucionet e Kosovës të ofrojnë aktivitete kundër pastrimit të parave, në veçanti të lidhura me implementimin efikas të kuadrit ligjor, bashkëpunim më të fuqishëm në mes të institucioneve kryesore me fokus në hetimet financiare dhe sigurimin e një përcjellje të qartë të aktvendimeve të lëshuara nga gjykatat në luftimin e kësaj dukurie.

Sipas Raportit të Progresit për Kosovën 2015, Komisioni Evropian (KE) ka gjetur se korniza ligjore e Kosovës është kryesisht në përputhje me Konventat e Vjenës dhe Palermos, pavarësisht mangësive të mbetura në lidhje me deklarimin e pasurisë nga zyrtarët e lartë publik.¹⁶ Gjithashtu, Kosova duhet të bëjë përpjekje për të harmonizuar legjislacionin dhe praktikën me rekomandimet e Grupit Punues për Veprime Financiare mbi Pastrimin e Parave (GPVF).¹⁷ Veç kësaj, KE ka vlerësuar se Plani i Veprimit të Kosovës duke përfshirë vlerësimin nacional të riskut në Pastrimin e Parave dhe Luftimit të Terrorizmit Financiar është zbatuar kryesisht me kohë.¹⁸

Megjithatë, procesi i implementimit të ligjeve, ligjeve dytësore dhe rregulloreve në pastrimin e parave dhe krimeve financiare janë ende të pamjaftueshme, pavarësisht progresit të arritur nga institucionet e Kosovës për të vënë sistem të përshtatshëm në vend. Më tepër, rezultatet vazhdojnë të mungojnë pavarësisht politikave të institucioneve të Kosovës për të zhvilluar hetime serioze sistematike financiare.¹⁹ BE-ja ka vlerësuar rritjen e numrit të rasteve kundër pastrimit të parave që janë dërguar në prokurori kryesisht nga policia gjatë vitit 2015, por ka vërejtje negative për pak dënime deri më sot. Në mënyrë që të shtohen rezultatet dhe dënimet, BE rekomandon thellimin e bashkëpunimit në mes të NJIF-it të Kosovës dhe aktorëve të tjerë të caktuar për ta luftuar pastrimin e parave. Sipas BE-së, është jetike në mënyrë të veçantë që bashkëpunimi dhe bashkëveprimi ndërmjet policisë dhe prokurorisë të përmirësohet dhe të forcohet më tej. Gjithashtu, ka rekomanduar forcimin e departamentit të anti-korrupsionit të Prokurorisë Speciale të Kosovës (PSRK), në mënyrë që të jetë

¹⁵ Organizata për demokraci, anti-korrupsion dhe dinjitet - Çohu, Qendra Kosovare për Gazetari Hulumtuese (QKGH), Preportr, gazeta periodike Nr.14, fq.2. I disponueshëm në, http://preportr.cohu.org/repository/docs/1509-Preportr14SHQIP_895529_359373.pdf

¹⁶ Komisioni Evropian, Raporti i Shtetit të Kosovës, fq.58. i disponueshëm në

http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2015/20151110_report_kosovo.pdf

¹⁷ Task Forca e Veprimit Financiar (TFVF) është organ ndërqeveritar i themeluar në vitin 1989 nga Ministri i Juridiksioneve të saj anëtare. Rekomandimet e FATF janë standardet globale të miratuara në nivel ndërkombëtar kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit; ata ngritin transparencën dhe mundësojnë vendeve për të marrë me sukses veprime kundër përdorimit të paligjshëm të sistemit të tyre financiar. Në dispozicion në, <http://www.fatf-gafi.org/about/>

¹⁸ Komisioni Evropian, Raporti i Progresit për Kosovën, fq.58.

¹⁹ Komisioni Evropian, Raporti i Progresit për Kosovën, fq.18.

në gjendje për të trajtuar më shumë raste të pastrimit të parave, duke punuar së bashku me Misionin Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë-EULEX.²⁰

Kriteret në lidhje me pastrimin e parave janë gjithashtu në mesin e kritereve të përcaktuara nga BE-ja për Kosovën në udhërrëfyesin e saj, për dhënien, Kosovës, regjimin e lirë të udhëtimit në vendet e BE-së. Në Udhërrëfyesin për Kosovën për liberalizimin e vizave, BE-ja kërkon nga institucionet e Kosovës, përmbushjen e kërkesave të mëposhtme të tilla si: pranojë dhe zbatojë legjislacionin për parandalimin, hetimin, ndjekjen dhe gjykimin e krimit të organizuar, duke përfshirë pastrimin e parave, krimin ekonomik dhe financiar, në përputhje me Acquis të BE-së, dhe të sigurojë që çdo ndryshim i ligjeve të reflektohet edhe në kodin penal dhe të krijojë një sistem të shëndoshë kundër pastrimit të parave. Sistemi kundër pastrimit të parave duhet të shoqërohet me rezultatet e implementimit të sistemit solid të konfiskimit të aseteve dhe menaxhimit dhe përforsimit të kapaciteteve të policisë dhe NJIF-së për të kryer në mënyrë efektive dhe të paanshme hetimet të natyrës komplekse të krimit të organizuar, duke përfshirë edhe pastrimin e parave dhe krimeve të tjera ekonomike. Në përgjithësi, BE-ja kërkon forcimin e kapaciteteve të policisë për të zbuluar dhe hetuar shërbimet prokuroriale, për të ndjekur penalisht, dhe gjykatësit për të gjykuar, në mënyrë të paanshme dhe efektive, rastet e ndërlikuara të krimit të organizuar, përfshirë krimet ekonomike dhe financiare.²¹ Kjo duhet të pasohet nga një histori e hetimeve dhe vendimeve të formës së prerë të gjykatave në rastet e krimit të organizuar dhe korrupsionit, duke përfshirë edhe pastrimin e parave. Në përfundim, raporti i tretë për Progresin e Kosovës²² në përmbushjen e kërkesave për liberalizimin e vizave thekson numrin e vazhdueshëm të ulët të dënimeve sa i përket krimeve të pastrimit të parave.

III. Korniza Ligjore për Luftimin e Pastrimit të Parave

Ligji ekzistues për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (më tutje Ligji i Pastrimit të Parave), u miratua në vitin 2010. Ligji iu nënshtrua ndryshimeve të para më 2013, dhe tre vjet më pas, për momentin, një ligj i ri është në diskutim dhe draftim.²³ BE-ja vuri në dukje se korniza ligjore e Kosovës në lidhje me luftën kundër pastrimit të parave është në masë të madhe në përputhje me standardet ndërkombëtare. Megjithatë, nisma për hartimin e ligjit të ri ka për qëllim që të përputhet me rekomandimet e Task Forcës për Veprimet Financiare të miratuara në vitin 2012²⁴ dhe direktivës së re të BE-së 2015/849 për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për

²⁰ Komisioni Evropian, Raporti i Progresit për Kosovën, fq.58.

²¹ Udhërrëfyesi për Liberalizimin e Vizave me Kosovën, fq.11. Në dispozicion në, http://ec.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu_travel/visa_liberalisation_with_kosovo_roadmap.pdf

²² Komisioni Evropian, Raporti i tretë i progresit për Kosovën në Përmbushjen e Kërkesave të Udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave fq.7. Në dispozicion në, http://ec.europa.eu/dgs/home-affairs/e-library/documents/policies/international-affairs/general/docs/third_report_progress_kosovo_fulfilling_requirements_visa_liberalisation_roadmap_en.pdf

²³ Draft ligji i disponueshëm tek KIPRED.

²⁴ Standardet Ndërkombëtare të Luftës kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit dhe Përhapjes, Rekomandimet e TFVF (Task Force e Veprimet Financiar), Rekomandimet B, 3. Veprat e pastrimit të parave. Në dispozicion në at, http://www.fatf-gafi.org/media/fatf/documents/recommendations/pdfs/FATF_Recommendations.pdf

qëllime të Pastrimit të Parave apo Financimit të Terrorizmit.²⁵ Më tutje, drafti i ri duhet doemos të adresojë kriteret e Grupit Egmont, i cili promovon në mes tjerash, zhvillimin e NJIF dhe bashkëpunimin.²⁶ Drafti i ri në përputhje me këto kritere do të stimulonte Kosovën të bëhet anëtare e Grupit Egmont.²⁷ Në veçanti, mangësitë e konstatuara nga Grupi Egmont kanë të bëjnë me pjesën e luftimit efektiv të krimeve financiare.²⁸ Më tutje, BE-ja ka vërejtur se ligji ekzistues dhe implementimi në përgjithësi i kornizës ligjore që i referohet krimeve financiare dhe ekonomike janë ende të pamjaftueshme.²⁹

Kur është fjala për përcaktimin e krimit të pastrimit të parave, në përputhje me rekomandimet e FATF (Task Forca e Veprimit Financiar), të gjitha vendet duhet ta penalizojnë aktin në bazë të Konventës së Vjenës dhe Konventës së Palermos.³⁰ Për shkak të kompleksitetit, krimi i pastrimit të parave duhet të definohet në disa mënyra. Një prej definicioneve që është më së shumti i përdorur është në përputhje me Nenin 3(b) (i) të Konventës së Vjenës. Rrjedhimisht, ligji i Kosovës, thekson në përputhje me Konventën se pastrimi i parave është... “Çdo vepër e cila ka për qëllim maskimin e origjinës së parave ose pronës tjetër të përfituara nga një krim duhet të përfshijë: konvertimi ose çdo transferim i parave ose pasurisë tjetër që rrjedhin nga aktiviteti kriminal; ose fshehja dhe maskimi i natyrës së vërtetë, origjinës, vendndodhjes, lëvizjes, disponimit, pronësisë ose të drejtave në lidhje me të holla ose pronës tjetër që rrjedh nga aktiviteti kriminal...”³¹

Krimi i pastrimit të parave në Kosovë është penalizuar nga ligji kundër pastrimit të parave të 2010, edhe pse më herët, e mbuluar me Rregulloren e UNMIK-ut mbi Pengimin e Pastrimit të Parave dhe Veprave Penale të ngjashme.³² Është gjithashtu e paraparë me Kodin e ri Penal të Kosovës (2013), në kapitullin XXV domethënë me Veprat Penale kundër Ekonomisë, së bashku me dënimet e

²⁵ DIREKTIVA (BE) 2015/849 E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT e 20 maj 2015 për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit, për ndryshimin rregulloren (EU) Nr. 648/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, dhe shfuqizimin e Direktivës 2005/60 / EC të Parlamentit Evropian dhe të Direktivës së Këshillit dhe Komisionit 2006/70 / EC.

²⁶ Egmont Group është një rrjet joformal i NJIF për nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar. NJIF të Egmont Group takohen rregullisht për të gjetur mënyra për të promovuar zhvillimin NJIF dhe për të bashkëpunuar, në veçanti në fushat e shkëmbimit të informacionit, trajnimit dhe shkëmbimit të ekspertizës. Në dispozicion në, <http://www.egmontgroup.org/about>

²⁷ Intervista e KIPRED me Koordinatorin Kombëtar për Krime Ekonomike, Janar 2016.

²⁸ Prokurori i Shtetit të Kosovës, Raporti tremujor (prill-qershor 2015) mbi aktivitetet dhe rekomandimet e Koordinatorit Kombëtar për Luftën kundër Krimeve Ekonomike, korrik 2015, fq. 10. Në dispozicion në, http://www.psh-ks.net/repository/docs/Raporti_%28prill_-_qershor_2015%29_shqip_-_per_publicim.pdf

²⁹ Fq.18 Raportit të BE-së për Progresin e Kosovës, 2015.

³⁰ Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe Substancave Psikotrope (1988) (më tutje: Konventa e Vjenës). Në dispozicion në, http://www.unodc.org/pdf/convention_1988_en.pdf Shih gjithashtu Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (2001), (më tutje: Konventa e Palermos). Në dispozicion në, http://www.unodc.org/pdf/crime/a_res_55/res5525e.pdf

³¹ Ligji Nr. 03/L-196 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (më tutje: ligji AML/ CFT), nëntor 2010, Neni 1, Paragrafi 1.23. Në dispozicion në, <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2010-196-eng.pdf>

³² Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2004/2 mbi pengimin e pastrimit të parave dhe veprave penale ngjashme, të ndryshuar me Rregulloren Nr. 2005/9. Në dispozicion në, http://www.unmikonline.org/regulations/2004/RE2004_02.pdf

përcaktuara në ligjin kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.³³ Ligji i tanishëm definon veprën penale të pastrimit të parave nën nenin 32 dhe parasheh dënim deri me dhjetë (10) vjet burgim dhe gjobë deri tri (3) herë më të madhe se vlera e pronës e cila është subjekti i veprës penale.³⁴ Përveç kësaj, Qeveria e Kosovës ka miratuar dy (2) Direktiva të tjera administrative (AD)³⁵ dhe gjashtë (6) tjera Udhëzime Administrative (UA)³⁶ të lidhura direkt me legjislacionin për zbatimin e parandalimit të pastrimit të parave. Projektligji i ri është duke kaluar në shqyrtim dhe është duke u finalizuar me disa anëtarë të shoqërisë civile të ftuar për të dhënë komente mbi procesin. Shoqëria Civile së fundmi ka ndarë komentet nën udhëheqjen e nismës e ndihmuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile për të shprehur shqetësimet e tyre lidhur me kërkesat e projekt-ligjit aktual në ndryshimin e kërkesave të raportimit të OJQ-ve. Për më tepër, komentet e shoqërisë civile janë në përputhje me komentet e BE-së dhe kritikën në Raportin e Progresit të BE-së të vitit 2014 e cila obligon organizatat e shoqërisë civile për të kërkuar leje për të gjitha donacionet mbi 1000 € nga një burim i vetëm dhe për të gjitha shpenzimet e mësipërme mbi 5000 € nga një burim i vetëm, nga NJJF.³⁷ Për më tepër, BE-ja e cilësoi mungesën e kriterëve për dhënien leje si një shqetësim. Projektligji i ri ka ulur shumën në 500 € dhe ka rritur më tej kritikën nga grupet e shoqërisë civile duke interpretuar këto kërkesa si ndërhyrje të mundshme me pavarësinë dhe punën në kohë të sektorit të OJQ-ve. Për më tepër, me këto kufizime të parapara, institucionet e Kosovës do të mbajnë një qëndrim akoma më të ashpër për sa i përket mbrojtjes *vis-à-vis* të organizatave të shoqërisë civile në krahasim me secilindo vend tjetër të rajonit të Ballkanit Perëndimor.

Me projektligjin e ri, Nenet 3 dhe 59,³⁸ kërkesat administrative të OJQ-së për të raportuar janë të parapara si vepra penale të ndjekura nga niveli i Prokurorisë Themelore në Kosovë. Ndryshimi në juridiksionin e hetimit është kritikuar nga shoqëria civile, pasi që këto vepra sipas ligjit të vjetër ishin nën kompetencë të veçantë të PSRK-së.³⁹ Si rezultat i presionit të shoqërisë civile projekt-ligji i ri duket se ka minimizuar kufizimet për sektorin e OJQ-së.⁴⁰ Kërkesat për raportimet e mësipërme do të aplikohen vetëm për transaksionet monetare të OJQ-ve. Edhe pse OJQ-të kanë treguar globalisht

³³ Shih neni 308 të Kodit Penal të Kosovës. Në dispozicion në, <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Kodi%20penal.pdf>

³⁴ Shih neni 32, në dispozicion në, <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2010-196-eng.pdf>

³⁵ AD FIU-K Nr. 02/2015 në Parandalimin dhe Zbulimin e Pastrimit të Parave, dhe AD Nr. 001/2013 Trajnim për parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Në dispozicion në, <http://fju.rks-gov.net/legjislacioni/>

³⁶ AI FIU-K nr. 05/2014 mbi Standardet Minimale, procedurat e shkruara dhe kontrollet për parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit nga profesionistët në fjalë, AI FIU-K nr. 04/2014 për Personat e ekspozuar politikisht, AI FIU-K nr. 03/2014 për Procedurën në Zbatimin e Sanksioneve administrative për mos-pëmbushje raportuese të subjekteve me LPMLTF, AI të Njësitit Hetues Financiar nr. 02/2014 në Përfundimin e transaksioneve të caktuara nga raportimi, AI MF – nr. 04/ 2013 mbi Pastrimin e Parave në nivel Kombëtar dhe vlerësimin e rrezikut të financimit të terrorizmit, AI nr. 001/2013 në përpilimin e statistikave, Raportet dhe Rekomandimet mbi Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, Në dispozicion në, <http://fju.rks-gov.net/legislation/?lang=en>

³⁷ Fq. 12 të Raportit të Progresit të BE-së për Kosovën, 2014.

³⁸ Projektligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, nenet 3 dhe 59, paragrafi 3. Projektligji në dispozicion në KIPRED.

³⁹ Komentet mundësuar dhe përgatitur nga KCSF, shkurt 2016. Në dispozicion nga KIPRED.

⁴⁰ Deklaratë e Zyrës Ligjore zyrtare NJJF, në tryezën e rumbullakët të organizuar nga KIPRED dhe Syri i Vizionit, 31 mars 2016 në Prishtinë.

kërcënimin potencial në luftën kundër terrorizmit, në përputhje me rekomandimet e FATF,⁴¹ QK ka arsyetuar ndalesat për kontrollin e abuzimit të mundshëm të OJQ-ve që mund të jetë e lidhur me organizatat terroriste ose me shoqata fetare.⁴² Megjithatë sektori i OJQ-ve mbetet i pa-kategorizuar në Kosovë duke i lënë të gjitha OJQ-të si një kërcënim të mundshëm. Përndryshe, organizata të ndryshme me karakter humanitar dhe fetar si dhe shoqatat fetare nuk konsiderohen OJQ-të.⁴³ Në mungesë të ligjit të ri për Liritë Fetare në Kosovë,⁴⁴ kërkesat për raportim e projekt-ligjit aktual e lënë jashtë këtij sektori nga të gjitha kërkesat e raportimit, duke përfshirë për shembull raportimin për pagesën e taksave të statusit të tyre të punonjësve.⁴⁵ Duke e lënë këtë sektor krejtësisht jashtë mbikëqyrjes së qeverisë, megjithatë sektori i OJQ-ve vazhdon të vëzhgohet. Balancimi i përshtatshëm dhe vlerësimi i rrezikut për këtë arsye duhet të marrë parasysh kërcënimet realiste dhe të mundshme. Ndërkohë, pasi Kosova po kalon draftimin e Ligjit të ri për Liritë Fetare, ajo duhet të marrë parasysh se largimi i mundshëm i sektorit të OJQ-ve nga parandalimi i tanishëm i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe kërkesat aktuale për raportimin e saj. QK do të duhej të synojë të caktoj bilanc duke bërë vlerësimin e rrezikut në mënyrë që të inkorporon organizatat që merren me ndihmë humanitare dhe/ose religjioze duke përfshirë edhe transaksionet e tyre financiare.

Në përgjithësi, ligji në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, është vlerësuar në masën të madhe në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe rekomandimet e FATF të vitit 2012, megjithatë mangësitë e saj në lidhje me luftën kundër pastrimit të parave në mënyrë efektive dhe financimit të terrorizmit janë duke u adresuar. Fokusi i ligjit duhet të jetë në adresimin dhe miratimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor që lidhet me hetimin, ndjekjen dhe dënimin e rasteve të pastrimit të parave, siç paraqitet më poshtë. Për më tepër, draft ligji aktual duhet të marrë në konsideratë klauzola balancuese për të adresuar boshllëqet e mundshme ligjore dhe kërcënimet reale nga sektori i OJQ-ve në përputhje me rekomandimet e FATF dhe nevojën për të kontrolluar transaksionet financiare të organizatave me natyrën bamirësie humanitare dhe/ose religjioze.

⁴¹ Shih fq. 54 të Rekomandimeve të FATF, Shënime interpretuese të Rekomandimit 9 për Organizatat Jofitimprurëse

⁴² Deklarata e zyrtarit të NJIF në Tryezën e KIPRED dhe SiV, 31 mars 2016 në Prishtinë.

⁴³ Shih nenin 2 të Ligjit për Lirinë e Asocimit të Sektorit Jo-Qeveritar,

⁴⁴ Liria e Bashkimit fetar në Kosovë ende rregullohet me Rregulloren e UNMIK 2006/48 mbi liritë e fesë në Kosovë.

Në dispozicion në http://www.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php?option=com_content&task=view&id=64&Itemid=28&lang=sq

⁴⁵ Shih Departamenti Amerikan i Shtetit Raporti mbi liritë fetare ndërkombëtare 2014, kapitulli për Kosovën. Në raport thuhet se grupet fetare rënë dakord të mos regjistrohen si OJQ ku shumë grupe raportonin vështirësi në regjistrimin e pronës dhe të automjeteve, hapjen e llogarive bankare, dhe pagimin e taksave mbi pagat e punonjësve. Pak bashkësi fetare ishin në gjendje për të hapur llogari bankare, por disa komunitete kanë pasur vështirësi për të marrë përsipër detyrat themelore financiare. Në dispozicion në

<http://www.state.gov/j/drl/rls/irf/religiousfreedom/index.htm#wrapper>

IV. Reagimi me Hetime, Ndjekje dhe Dënime të Krimeve që ndërlidhen me Pastrimin e Parave

Kosova konsiderohet se ka shënuar progres në vendosje e një regjimi strategjik kundër pastrimit të parave.⁴⁶ Në shtator 2014, QK ka adaptuar Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit për Parandalimin dhe Luftën kundër Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare për periudhën 2014-2018.⁴⁷ Rrjedhimisht është përgatitur edhe një raport kombëtar për vlerësimin e rrezikut ndaj pastrimit të parave dhe financimin e terrorizimit.⁴⁸ Megjithatë, reagimi institucional në luftën kundër pastrimit të parave ka qenë i dobët për shkak të ndërhyrjeve politike, mungesës së gatishmërisë për të vepruara nga ana e institucioneve përkatëse, i cili është përcjellë me një mungesë të kapaciteteve për të trajtuar lëndët që kanë të bëjnë me pastrimin e parave, gjë që ka penguar edhe luftimin në kohë të pastrimit të parave.

Duke qenë se krimi i pastrimit të parave shpeshherë është i ndërlidhur me krime të tjera përfshirë korrupsionin dhe krimin e organizuar, institucionet e sundimit të ligjit kanë nevojë që të luftojnë aktivitetet që merren me pastrimin e parave, duke përfshirë korrupsionin ndaj profilit të lartë, ekonomisë joformale dhe shmangies së taksave.⁴⁹ Për më tepër pasuria e raportuar vjetore e zyrtarëve publik dhe pasuria e tyre e pashpjegueshme janë konsideruar si gjurmë të dobishme në kryerjen e hetimeve të mundshme kundër pastrimit të parave dhe çështjet që lidhen me korrupsionin.⁵⁰

Për më tepër sukcesi në hetimin e krimit të pastrimit të parave varet shumë në raportimin cilësor të aktiviteteve potenciale të pastrimit të parave, si dhe në koordinim dhe bashkëpunimin me institucionet e mandatuara. Reagimi duhet të vijë nga një numër i madh i palëve të interesuara, të cilat kanë përgjegjësinë dhe bartin kompetencat përkatëse për të luftuar aktivitetet e pastrimit të parave. Megjithatë i takon Prokurorisë Speciale dhe shërbimeve të prokurorisë në përgjithësi që të jenë lider në këtë drejtim. Gjurmimi i dobët i rasteve të hetuara, akuzuara dhe dënuar (vetëm një rast në vitin 2015) në luftën kundër pastrimit të parave tregon mangësi në kryerjen e detyrave nga ana e institucioneve përgjegjëse si dhe rrjetit koordinues dhe bashkëpunues. Institucionet e mandatuara justifikojnë punën e tyre të kufizuar duke u thirrur në kompleksitetin e krimit të pastrimit të parave dhe mungesën e një kornize ligjore dhe kapaciteteve institucionale. Për më tepër, ekziston një

⁴⁶ Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara, f.249.

⁴⁷ Ministria e Financave të Republikës së Kosovës “Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin e Luftimit Ekonomisë Jo-formale, pastrimit të parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve financiare 2014-2018” I disponueshëm në: <https://mf.rks-gov.net/en-us/National-Strategy>

⁴⁸ Dokumenti nuk është bërë publik, edhe me kërkesë të KIPRED-it.

⁴⁹ Deklarata e zyrtarit të EULEX-it në tryezën e rumbullakët të organizuar nga KIPRED dhe Syri i Vizionit, 31 mars 2016 në Prishtinë

⁵⁰ Shih për shembull Raportin e KIPRED-it “Pandëshkueshmëria në Kosovë: Pasuria e Pashpjegueshme” Nëntor 2013.

I disponueshëm në:

http://www.kipred.org/repository/docs/THE_IMPUNITY_IN_KOSOVO_INEXPLICABLE_WEALTH_632453.pdf

tendencë për t'ia hedhur fajin dikujt tjetër⁵¹ në rezultatet përgjithësisht të dobëta në luftën ndaj fenomenit të pastrimit të parave.

a) Ndjekja penale e krimit të pastrimit të parave

Shërbimet e prokurorisë dhe në veçanti gjykatat vazhdojnë në mënyrë të dobët të kryejnë hetimet, ngritjen e akuzave dhe nxjerrjen e vendimeve përfundimtare në rastet që ndërlidhen me aktivitetet pastrimit të parave. Zyra e Prokurorit Special të Republikës së Kosovës (ZPSRK) vazhdon të mbajë kompetencat ekzekutive kryerjen e hetimeve dhe ndjekjen penale të rasteve që kanë të bëjnë me pastrimin e parave.⁵²

Ndjekja e dobët shpeshherë është justifikuar me faktin se krimi i pastrimit të parave është për nga natyra çështje komplekse dhe shpesh përfshinë edhe transaksione ndërkombëtare, të cilat është vështirë që të ndiqen.⁵³ Megjithatë, edhe pse nga natyra mund të jenë çështje komplekse, nëse aktivitetit përqendrohen në transaksione të dyshimta kriminale që përfshijnë edhe pastrimin e parave, mund të kapen lehtë nëse ato ndiqen me kujdes. Si do që të jetë, ekziston një mungesë e iniciativës dhe gatishmërisë nga ana e shërbimeve të prokurorisë për të hetuar dhe ndjekur penalisht rastet, duke u justifikuar shpesh me nevojën që Kosova ka për të draftuar një ligj special në mënyrë që të bartet barra e provave mbi të pandehurin e dyshuar.⁵⁴ Ligji i ri i iniciuar në vitin 2015, i njohur si “Ligji anti-mafia” do të bënte që fondet e paligjshme të jenë lehtësisht në dispozicion për sekuestrimin, konfiskimin ose konfiskim pa dënim të formës së prerë, me kërkesën që i pandehuri i dyshuar të ofrojë dëshmi se fondet ekzistuese nuk janë fonde të paligjshme dhe nuk rrjedhin nga aktivitetet kriminale dhe ilegale.⁵⁵ Parimi i njohur si “kthimi i barrës së provave” kërkon që pala e pandehur e dyshuar të vërtetojë origjinën e fondeve të veta dhe mënyrën se si këto fonde janë krijuar. Megjithatë, legjislacioni i Kosovës i cili është në fuqi parashikon dispozita ligjore të përmirësuara dhe të zgjeruara në lidhje me hetimin dhe ndjekjen e rasteve që ndërlidhen me pastrimin e parave në mënyrë të veçantë nëse krahasohen me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës të vitit 2003.⁵⁶ Prokurori i Shtetit ka mjete më të mira në dispozicion për të hetuar veprën penale të pastrimit të parave dhe në identifikimin e llogarive bankare që mund të përmbajnë fonde të paligjshme, duke ngrirë ato fonde në mënyrë të shpejtë nëse një gjë e tillë konsiderohet e nevojshme. Aktakuza nga Prokurori i Shtetit duhet të radhis pasuritë e dyshimta të cilat kanë rrjedhur nga veprat penale apo që janë rezultat nga përfitimet e veprave penale.⁵⁷ Gjykata duhet të marrë në konsideratë autoritetin e fuqishëm të prokurorëve për të ngrirë, sekuestruar dhe konfiskuar mjetet. Në rastet që ndërlidhen shkelje penale në lidhje me korrupsionin, përrshirë për shembull edhe rastet që kanë të

⁵¹ PECK Raporti i Vlerësimit 2014, f.64.

⁵² Neni 5 i Ligjit të Kosovës për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, i disponueshëm tek http://www.gazetazartare.com/e-gov/index.php?option=com_content&task=view&id=143&Itemid=56&lang=en

⁵³ Informacion i bazuar në diskutime, Transkripti Zyrtar nga tryeza e rrumbullakët e organizuar nga KIPRED dhe Syri i Vizionit, 31 mars 2016 në Prishtinë.

⁵⁴ Po aty.

⁵⁵ Kopja e projektligjit, i disponueshëm në KIPRED.

⁵⁶ Shih f.42 “Udhëzues për Kodin e Procedurës Penale të Kosovës si dhe Kodin e Procedurës Penale të Kosovës” nga Jon Smibert për Departamentin e Drejtësisë të Shteteve të Bashkuara (US DoJ), OPDAT Ambasada e SHBA-ve, Prishtinë, 2003. Kopja e disponueshme në KIPRED.

⁵⁷ Po aty.

bëjnë me dhënien e ryshfetit, Kodi i ri i Procedurës Penale në bazë të nenit 281 favorizon konfiskimin e mjeteve në rastet kur ka ndonjë aktakuzë për veprë penale të korrupsionit, atëherë dhënia e ryshfetit mund të mos kthehet, edhe nëse i pandehuri është liruar.⁵⁸

Për më tepër nëse mjetet konfiskohen me anë të një urdhri të gjykatës, gjykatat brenda 60 ditësh duhet të kryejnë sekuestrimin e përhershëm duke bërë në këtë mënyrë shqyrtimin e urdhrin. Sipas nenit 275, paragrafi 3, Prokurori i Shtetit këshillohet që të shfrytëzojë ekspertë të kualifikuar financiar të cilët mund të ofrojnë opinion e tyre në lidhje me atë nëse ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme apo astet e tjera të përcaktuara në aktakuzë janë rrjedhojë e veprës penale që është nën hetim, në bazë të raportit apo në bazë të dëshmisë së nxjerrë nga shqyrtimi gjyqësor.⁵⁹

Megjithatë, ka mungesë të vullnetit nga ana e Prokurorisë Speciale për të shfrytëzuar ekspertizën financiare, të cilën e ka në dispozicion. Edhe pse ekspertët janë të profilizuar, duke përfshirë nëntë (9) ekspertë financiarë që mbulojnë prokurimin, taksat dhe çështje të tjera financiare, ndihma e tyre është përdorur shumë rrallë nga ana e prokurorëve special.⁶⁰ Mbi të gjitha, korniza ligjore duket se është e mjaftueshme dhe prokurorët preferojnë që të gjejnë një zgjidhje më të lehtë për trajtimin e rasteve të korrupsionit të profilit të lartë si dhe të aktiviteteve të mundshme të pastrimit të parave, duke e bartur barrën e provave tek të pandehurit e dyshuar. Institucionet e Kosovës duhet të sigurojnë se çdo iniciativë në të ardhmen për të bartur barrën e provave në rastet që kanë të bëjnë me hetimin e veprave penale të pastrimit të parave dhe krimeve ekonomike, të jetë e balancuar me mbrojtjen e të drejtave pronësore të të pandehurve dhe çdo shkelje të mundshme që mund të vije si rezultat i qasjeve selektive nga ana e prokurorëve të shtetit.

Në përgjithësi, prokurorët e shtetit kanë mungesë të gatishmërisë për të shtyrë përpara dhe kryer hetimet në rastet e pastrimit të parave. Siç del nga të dhënat e prokurorëve, performanca e tyre është e dobët. Për shembull gjatë vitit 2015, PSRK ka pranuar nëntë (9) kallëzime penale kundër 27 personave. Shtatë (7) prej këtyre kallëzimeve janë parashtruar nga Policia e Kosovës, një (1) është parashtruar nga NJIF dhe një (1) me vetë iniciativë të prokurorit të shtetit.⁶¹ Gjatë vitit 2015, PSRK ka trashëguar edhe 28 kallëzime penale nga viti 2014 duke filluar vitin 2015 me 36 raste në lidhje me pastrimin e parave.

Megjithatë gjatë vitit 2015 PSRK ka arritur që të zgjidh vetëm gjashtë (6) raste të pastrimit të parave prej 36 rasteve, duke lënë 83% të rasteve të tilla të pazgjidhura dhe vetëm 17% e rasteve të zgjidhura.

⁵⁸ f.42 *supra note* në 53.

⁵⁹ Po aty.

⁶⁰ Deklarata e zyrtarit të lartë të Zyrës së BE-së në Kosovë, në tryezën e rumbullakët të organizuar nga KIPRED dhe Syri i Vizionit, tetor 2015 në Prishtinë.

⁶¹ Raporti Vjetor 2015, dorëzuar në KIPRED nëpërmjet komunikimit me e-mail nga Këshilli Prokurorial i Kosovës (Janar 2016). Shih gjithashtu Raportin Vjetor për vitin 2014, i disponueshëm në: http://www.psh-ks.net/repository/docs/TRACKING_MECHANISM_ANNUAL_REPORT_FOR_2014.pdf.

Rezultatet janë të dobëta krahasuar me vitin 2014 ku PSRK ka zgjidhur 14 raste apo 67% të rasteve të pazgjidhura dhe vetëm 33% e rasteve të zgjidhura.⁶² (Shih Tabelën 1.1)

Tabela 1.1: Rezultatet e PSRK-së në zgjidhjen e lëndëve të Pastrimit të Parave, periudha 2014-2015				
Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK)	Numri i lëndëve të zgjidhura	% e lëndëve të zgjidhura	Numri i lëndëve të pazgjidhura	% e lëndëve të pazgjidhura
Viti 2014	14	33%	28	67%
Viti 2015	6	17%	30	83%

Burimi: Këshilli Prokurorial i Kosovës

Për më tepër, gjatë vitit 2015, prej 6 lëndëve të zgjidhura prej 36 lëndëve në total, PSRK ka raportuar se ka zgjidhur lëndë duke akuzuar gjashtë (6) persona, duke urdhëruar të merren masa për trajtim psikiatrik për 4 persona⁶³ dhe duke ndërprerë hetimet kundër 4 personave. Deri në fund të vitit 2015 prokurorët e PSRK-së nuk janë marrë me kallëzime penale kundër 92 personave. Për më tepër, dënimet kanë qenë më të ulëta në vitin 2015 krahasuar me vitin 2014 ku 18 persona janë dënuar, nga numri i përgjithshëm i lëndëve të zgjidhura kundër 37 personave.

Në justifikimin e performancës së tyre të dobët, prokurorët kanë raportuar se cilësia e kallëzimeve penale të dorëzuar nga Policia e Kosovës është e dobët. Prokurorët gjithashtu kanë pranuar përgjegjësinë për parashtrimin e aktakuzave të dobëta për shkak të kompleksitetit të natyrës së lëndëve të pastrimit të parave, duke çuar rrjedhimisht në rrëzimin e lëndëve nga ana e gjykatave.⁶⁴ Për shembull, nëpër tërë Kosovën në vitin 2015, prokurorët kanë urdhëruar sekuestrim të përkohshëm në vlerë prej 20,000,000.00 € në lidhje me raste që kanë të bëjnë me krimet ekonomike, duke përfshirë shkelje penale në lidhje me narkotikët dhe krimin e organizuar. Përveç kësaj, Koordinator i Kombëtar i Kosovës për Krimet Ekonomike ka raportuar gjithashtu se në rastet që kanë të bëjnë me veprat penale për lëndët narkotike dhe të drogës, prokurorët ka qenë të gatshëm të përdornin urdhra për sekuestrimin dhe konfiskimin edhe për rastet në lidhje me kapjen e automjeteve për transportimin e drogës.⁶⁵ Për më tepër, gjykatat kanë vazhduar që të lëshojnë një

⁶² Tabela reflekton vetëm lëndët që janë punë e sipër pranë PSRK. Një (1) lëndë për pastrimin e parave është raportuar nga Prokuroria Themelore e Prizrenit në vitin 2014. Lënda është transferuar dhe mbetet e pazgjidhur deri në vitin 2015.. Statistikat e nxjerra me anë të komunikimit me e-mail mes KIPRED dhe Zyrtarëve të Këshillit Prokurorial të Kosovës, Raporti Vjetor 2015, janar 2016.

⁶³ KIPRED ka kërkuar sqarime në lidhje me trajtime psikiatrike të urdhëruara në rastet e pastrimit të parave pranë KPK. Deri më tash asnjë përgjigje nuk është parashtruar.

⁶⁴ Deklarata e Prokurorit të Shtetit dhënë në tryezën e rrumbullakët të organizuar nga KIPRED dhe Syri i Vizionit, 31 mars 2016 në Prishtinë.

⁶⁵ Shih f.4 të “Raportit tre-mujor mbi aktivitetet dhe rekomandimet e Koordinatorit Kombëtar kundër Krimeve Ekonomike, tetor-dhjetor 2015,” për Këshillin Prokurorial të Kosovës. Kopja e disponueshme në KIPRED.

numër të vogël të aktgjykimeve të formës së prerë në lëndët në lidhje me pastrimin e parave, duke lëshuar kështu vetëm një (1) aktgjykim të tillë në vitin 2015. Si rezultat i mos lëshimit të aktvendimeve të formës së prerë dhe rrëzimit të lëndëve nga ana e gjykatave, buxheti i Kosovës po person dëme të konsiderueshme me shuma të mëdha të mjeteve të mbetura nën administrimin në pritje të konfiskimit të përhershëm nga ana e shtetit. Të ngelur në një lojë të hedhjes së fajësisë në pafundësi në mes të përmbarrimit, prokurorisë dhe gjykatave, Këshilli Prokurorial i Kosovës duhet megjithatë që të rris kapacitetet e veta të monitorimit dhe të vlerësojë në thellësi llogaridhënien e shërbimeve të prokurorisë në zgjidhjen e lëndëve që kanë të bëjnë me pastrimin e parave. Analiza e mëtejme duhet të fokusohet në gjetjen e arsyeve për rezultate të dobëta në hetimin, ndjekjen dhe dënimin cilësor të rasteve që kanë të bëjnë me pastrimin e parave.

Gjithashtu PSRK vazhdon të punojë me kapacitete të kufizuara, me një numër të pamjaftueshëm të prokurorëve dhe në mungesë të ekspertëve të specializuar për lëndët që kanë të bëjnë me pastrimin e parave.⁶⁶ Prokurorët special vazhdojnë të punojnë në numër të vogël, duke qenë nëntë (9) prokurorë që merren me lëndë që kanë të bëjnë me pastrimin e parave dhe krime të tjera serioze, krimin e organizuar dhe korrupsionin. Kapacitet e limituara për të rekrutuar prokurorë të rinj mund të pengohet nga natyra e ndjeshme e lëndëve që merren prokurorët special. Përveç kësaj, Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike ka raportuar se burimet e limituara njerëzore të PSRK-së vazhdojnë të pengohen nga procedurat e brendshme të rekrutimit të shërbimeve të prokurorisë.⁶⁷ Koordinatori për më tepër rekomandon që Ministria e Drejtësisë e Kosovës duhet të bëjë ndryshimin e Ligjit mbi PSRK-në të vitit 2008, me qëllim që të lejohet mundësia e përfshirjes së juristëve të dalluar që të aplikojnë për t’ju bashkuar PSRK-së. Rregulli aktual i rekrutimit kërkon që prokurorët të kenë kaluar të paktën shtatë vite shërbimi brenda prokurorisë, duke u mbështetur në këto procedura të rrepta të brendshme të rekrutimit të shërbimeve të prokurorisë në rritjen e numrit të prokurorëve brenda PSRK-së, deri më tani nuk ka nxjerrë asnjë rezultat. Përbërja aktuale e PSRK-së jo domosdoshmërisht ka ofruar kandidatë të kualifikuar, duke shprehur në këtë mënyrë ngurrimin e tyre në hetimin e rasteve që lidhen me hetimin e pastrimit të parave.

Për më tepër, kur është fjala për veprimet e ndërmarra nga prokurorët e PSRK-së në lidhje me veprat penale të pastrimit të parave, gjatë vitit 2015 prokurorët kanë konsideruar se nuk ka pasur fare nevojë që të kërkoheshin informacione shtesë dhe urdhëresa për masa të fshehta në lidhje me hetimet e pastrimit të parave. Ndryshe, gjatë vitit 2014, ka pasur 34 kërkesa nga prokurorët për informacion shtesë me të paktën nëntë (9) urdhëresa për masa të fshehta të kërkuara (Shih: Shtojca Tabela 1.5). Duke i shtuar ngurrimit të raportuar të prokurorëve special për të shfrytëzuar ekspertizën e nëntë (9) ekspertëve financiarë që PSRK ka në dispozicion, mbetet akoma një shqetësim se prokurorët special nuk kërkojnë informata shtesë dhe nuk janë duke përdorur masat e fshehta, duke marrë parasysh kompleksitetin e krimeve të pastrimit të parave. Në veçanti, këto mangësi mbeten një pengesë në përgatitjen e rasteve pasi që prokurorët kanë argumentuar se janë

⁶⁶ Deklarata e Prokurorit të Shtetit dhënë në tryezën e rumbullakët të organizuar nga KIPRED dhe Syri i Vizionit, 31 mars 2016 në Prishtinë .

⁶⁷ Shih f.4 të “Raportit tre-mujor mbi aktivitetet dhe rekomandimet e Koordinatorit Kombëtar kundër Krimeve Ekonomike, tetor-dhjetor 2015,” për Këshillin Prokurorial të Kosovës. Kopja e disponueshme në KIPRED.

përballur me vështirësi në të provuarit e rasteve të tyre para gjykatave si rezultat i mungesës së provave.

Në përgjithësi mungesa e iniciativës dhe gatishmërisë për të punuar në veprat penale komplekse në lidhje me pastrimin e parave mund të jetë objekt i ndërhyrjeve të mundshme politike, gjë që mund të mos jetë raportuar nga ana e prokurorëve special. Deri më tani prokurorët special rrallëherë kanë raportuar se kanë pasur ndonjë presion të jashtëm nga ana e të pandehurve të dyshuar, pasi që ata shumë rrallë kanë trajtuar rastet e profilit të lartë, duke përfshirë edhe rastet që përfshijnë figura politike të profilit të lartë.⁶⁸ Për Kosovën është e njohur se ka pasur një rritje të konsiderueshme të pasurisë së zyrtarëve të lartë publik, krahasuar me të ardhurat e tyre vjetore, të cilat mund të gjurmohen lehtë përmes monitorimit të deklarimit të mjeteve dhe pasurisë së tyre pranë Agjencinë Kundër Korrupsionit.⁶⁹ Pasi që pasuria e pashpjegueshme mbetet e paprekshme në Kosovë, prokurorët special vazhdojnë të rrinë në zonat e tyre të rehatisë, duke raportuar apo kërkuar shumë rrallë masa mbrojtëse.

Për më tepër, është raportuar se zyrtarët institucionalë që kanë denoncuar aktivitetet e mundshme të pastrimit të parave, shpesh janë ballafaquar me masat arbitrare nga drejtuesit e tyre, shpesh duke u përcjellë me pezullimin ose transferimin në degët e tjera institucionale.⁷⁰ Pa një zhvillim të një mekanizmi të duhur për të mbrojtur si duhet “treguesit” e mundshëm, raportimi i suksesshëm dhe hetimi i veprave penale të pastrimit të parave do të vazhdojë të jetë i ulët.

Duke pasur një përgjigje minimale nga ana e PSRK-së në ndjekjen e aktiviteteve të pastrimit të parave, mbetet shumë i ulët probabiliteti se Kosova do të zhvillojë një histori në hetimin dhe ndjekjen e veprave penale të pastrimit të parave. Roli që gjykatat kanë luajtur në këtë drejtim, e kanë çuar Kosovën larg nga krijimi i rezultateve të suksesshme në hetimin, ndjekjen penale dhe dënimin e veprave penale të pastrimit të parave dhe krimeve ekonomike në përgjithësi.

b) Reagimi i gjyqësorit

Kosova vazhdon të ketë Prokurori Speciale në nivel kombëtar me kompetenca ekskluzive dhe kompetenca plotësuese për të hetuar dhe ndjekur penalisht krimet e organizuara, terrorizmin, veprat e pastrimit të parave dhe krimet e lidhura me korrupsionin.⁷¹ Struktura ekzistuese e gjykatës vendore gjithashtu merret me vepra penale të ngjashme sikurse PSRK, megjithatë që janë të dënueshme deri në dhjetë vite apo më shumë me burgim në bazë të ligjit, përfshirë këtu edhe vrasjet e rënda.⁷² Këto

⁶⁸ Burim i KIPRED-it, Prokuroria Speciale pranë PSRK, 2015.

⁶⁹ Shih për shembull Raportin e KIPRED-it “Pandëshkueshmëria në Kosovë: Pasuria e Pashpjegueshme” Nëntor 2013. I disponueshëm në

http://www.kipred.org/repository/docs/THE_IMPUNITY_IN_KOSOVO_INEXPLICABLE_WEALTH_632453.pdf

⁷⁰ Deklarata e zyrtarit të sundimit të ligjit dhënë në tryezën e rrumbullakët të organizuar nga KIPRED dhe Syri i Vizionit, 31 mars 2016 në Prishtinë.

⁷¹ Neni 5 dhe 9 i Ligjit mbi Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës të Republikës së, 2008. I disponueshëm në http://www.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php?option=com_content&task=view&id=143&Itemid=56&lang=en

⁷² Neni 15, paragrafi 21 i Ligjit mbi Gjykatat e Kosovës, i adaptuar në vitin 2010. I disponueshëm në <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2010-199-eng.pdf>.

krime janë trajtuar në bazë të strukturës së re të gjykatave në kuadër të Departamentit të Krimeve të Rënda të Gjykatave Themelore megjithatë gjyqtarët vazhdojnë të merren në baza ditore me një numër të madh të rasteve në kuadër të Departamentit për Krime të Rënda, duke trajtuar edhe raste të dënueshme me dhjetë ose më shumë vite.

Gjykatat e Kosovës vuajnë nga mungesa endemike e burimeve njerëzore me një buxhet vjetor të ndarë vetëm në vitin 2015 nga Qeveria e Kosovës, duke arritur në 1.14% të Buxhetit Vjetor të Kosovës për vitin 2015.⁷³ Gjykatat kanë numër të vogël të gjyqtarëve kur krahasohen me numrin e ulët të lëndëve të zgjidhura. Për shembull, Gjykata Themelore e Prishtinës gjatë vitit 2015 ka punuar me vetëm dymbëdhjetë (12) gjyqtarë në Departamentin e Krimeve të Rënda, me 1970 lëndë të pazgjidhura të cilat janë transferuar nga viti 2014. Ndërsa viti 2016 ka filluar me 2170 lëndë të pazgjidhura.⁷⁴ Ky departament ka zgjidhur vetëm 520 raste prej 2732 rasteve në pritje për t'u zgjidhur.⁷⁵ Kushtet e caktuara nga Udhërrëfytyesi për Liberalizimin e Vizave kanë mundësuar që në janar 2016, gjashtë (6) gjyqtarë të transferohen në Departamentin e Krimeve të Rënda dhe tani ky departament ka 18 gjyqtar.⁷⁶ Qeveria e Kosovës vazhdon të argumentojë duke thënë që nuk ka nevojë të rritet edhe më tutje numri i gjyqtarëve.⁷⁷ Shërbimet e gjyqësorit në Kosovë vazhdojnë të punojnë me mungesa serioze sistematike dhe të burimeve njerëzore, duke penguar në këtë mënyrë edhe kryerjen e efikase të punëve të gjyqësorit ndaj qytetarëve të Kosovës. Nga mesi i vitit 2015 gjyqësori ka pasur 400.000 lëndë të pazgjidhura nga lëndët e grumbulluara të trashëguara ndër vite.⁷⁸ Gjatë vitit 2016 është vazhduar që të punohet me një buxhet vjetor prej 1.22% të ndarë nga Ministria e Financave për sektorin e gjyqësisë.⁷⁹

Rezultatet e dobëta justifikohen gjithashtu me kërkesën e zyrtarëve gjyqësorë për të siguruar një departament të veçantë/gjykatë e cila do të merrej me rastet e PSRK-së.⁸⁰ Sipas mendimit të gjykatave është e pamundur të tregohen rezultate efikase në zgjidhjen e rasteve që lidhen me pastrimin e parave, duke u marrë në një anë edhe me një numër të caktuar të krimeve të përgjithshme siç është edhe vrasja e rëndë.⁸¹ Megjithatë këto nevoja kanë vazhduar të plotësohen brenda afateve kohore nën prioritetet aktuale të qeverisë në mënyrë të përforcimit të sundimit të ligjit.

Kur bëhet fjalë për dënimet në rastet e pastrimit të parave, gjykata e Kosovës gjatë vitit 2015 kanë arritur që të lëshojnë vetëm një (1) aktvendim kundër një (1) personi, i cili është shpallur fajtor si në

⁷³ Buxheti për Këshillin Gjyqësor të Kosovës për vitin 2015 mbulon të gjitha shpenzimet in 2015 mbulon të gjitha shpenzimet e gjyqësorit të Kosovës përfshirë edhe burimet njerëzore. Shih Ministrinë e Financave, Ligji Nr.05-L-001 mbi Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015. I disponueshëm në <https://mf.rks-gov.net/sq-al/Buxheti/Buxheti-i-Republikes-se-Kosoves/Buxheti-qendrore>

⁷⁴ Shih faqen 10 të "Raportit Vjetor të Statistikave të Gjykatave – 2015", Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Shkurt 2016. I disponueshëm në:

file:///C:/Users/PC/Downloads/RAPORTI%20I%20PERGJITHSHEM%202015_22_02_2016.pdf

⁷⁵Po aty.

⁷⁶ Shih f.1 në lidhje me përmbushjen nga ana e Kosovës e tetë rekomandimeve të mbetura nga Dialogu për Liberalizimin e Vizave, Janar 2016. Kopja e fortë pranë KIPRED.

⁷⁷ Ibid, f.2.

⁷⁸ Shih f.35 të Raportit të Progresit për Kosovën 2015.

⁷⁹ Shih Ministrinë e Financave, Ligji mbi Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016.

⁸⁰ KIPRED Intervistë me ish kryetarin e KGJK-së z. Peci, gusht 2015.

⁸¹ KIPRED Intervistë me gjyqtarin e Gjykatës Themelore në Prishtinë gusht 2015.

dënim.⁸² Gjatë vitit 2014 nuk ka pasur asnjë dënim të lëshuar nga ana e Gjykatave në lidhje me aktakuzat në rastet e pastrimit të parave. (Shih Tabelën 1.2) Rezultate e dobëta shpeshherë justifikohet me njohuritë e kufizuara dhe përvojën e gjyqësorit të Kosovës në trajtimin e veprave penale që lidhen me pastrimin e parave.⁸³

Pos institucioneve të Kosovës, Misioni i BE-së për sundimin e ligjit, EULEX, ka trajtuar raste që lidhen me pastrimin e parave. EULEX-i nuk i ka pasur në mënyrë specifike në cak rastet e pastrimit të parave, edhe pse ata kanë qenë pjesë e hetimeve ndaj krimit të organizuar. Në qershor të vitit 2014, EULEX-i kishte në pritje për t'i zgjidhur tetë (8) raste në lidhje me pastrimin e parave, të cilat po trajtoheshin nga ana e prokurorëve të tyre.⁸⁴ Gjatë vitit 2014 dhe 2015, prokurorët e tyre kanë parashtruar gjithsej katër (4) aktakuza në rastet që lidhen me pastrimin e parave. Rrjedhimisht, janë lëshuar dy (2) aktgjykime, në njërin prej rasteve, të pandehurit janë liruar ndërsa në rastin tjetër të pandehurit janë shpallur fajtorë dhe janë dënuar *inter alia* për atë vepër penale.⁸⁵

Tabela 1.2: Vendimet e gjykatave për personat e dënuar në lidhje me veprën penale të pastrimit të parave, gjatë periudhës 2013, 2014 dhe 2015		
Viti	Numri i personave kundër të cilëve gjykata ka lëshuar një vendim	Numri i personave të shpallur fajtorë
2013	-	-
2014	-	-
2015	1	1

Burimi: Këshilli Prokurorial i Kosovës

Rezultatet e dobëta në dënimet kundër veprave penale të pastrimit të parave, mungesa e burimeve njerëzore në gjykata dhe e gjyqtarëve të specializuar vazhdon të jenë pengesë në kryerjen efikase të mandatit të tyre. Me qëllim të ngritjes së rezultateve të gjyqësorit për luftimin e krimeve të ndërlikuara, siç janë krimi i organizuar, veprat penale të pastrimit të parave dhe luftën kundër korrupsionit të profilit të lartë, gjyqësori i Kosovës duhet të bëjë një analizë të plotë të mangësive aktuale në kuadër të sistemit gjyqësor me qëllim që të fillohen reformat me anë të së cilave do të mund të mbështetëj zbatimi i specializimit të mëtejshëm të gjykatave dhe rritja e numrit të gjyqtarëve në bazë të nevojave.

Në fund, institucionet e sundimit të ligjit kanë nevojë që të rrisin përpjekjet e tyre në kryerjen e hetimeve të suksesshme, ndjekjen dhe shpalljen e dënimeve në lidhje me veprat penale të pastrimit të parave, ashtu siç kërkohet edhe nga BE-ja. Përveç kësaj, ata duhet të adresojnë nevojat e tyre

⁸² Këto statistika janë të bazuara në Raportin Vjetor 2015, të dorëzuara në KIPRED me anë të komunikimit me e-mail nga Këshilli Prokurorial i Kosovës (Janar 2016) i njohur si Mekanizmi ndër-institucional për ndjekje i KPK-së. Ndryshe gjykatat kanë raportuar 2 raste të dënimeve në lidhje me pastrimin e parave gjatë vitit 2014 dhe asnjë rast për vitin 2015. . KIPRED komunikim me e-mail me Drejtorin e KGJK Departamenti i Statistikave, prill 2016.

⁸³ KIPRED intervistë me Koordinatorin Kombëtar për Krime Ekonomike, 29 janar 2016 në Prishtinë.

⁸⁴ Komunikim me e-mail në mes të KIPRED dhe EULEX, Zyra për Marrëdhënie me Publikun Shkurt 2016.

⁸⁵ Po aty.

institucionale në përputhje me rrethanat e caktuara në mënyrë që të rrisin rezultatet e tyre në këtë fushë. Këto nevoja duhet të adresohen edhe nga qeveria duke siguruar që të gjitha institucionet kryesore të mandatuara për të luftuar pastrimin e parave janë të pajisura plotësisht me burimet njerëzore, janë të trajnuar mirë dhe që posedojnë pavarësinë e tyre të nevojshme nga çdo ndërhyrje të mundshme politike.

c) Roli i institucioneve të tjera në hetimin e krimeve të pastrimit të parave

Sikurse që është rastit me institucionet e tjera të sundimit të ligjit, edhe Policia e Kosovës ka një rol të konsiderueshëm në hetimin e krimeve të pastrimit të parave. Policia vazhdon të përballet me një numër të madh të sfidave, përfshirë këtu edhe ekonominë joformale, qarkullimin e parasë së gatshme dhe pasurisë së paregjistruar.⁸⁶ Hetimet e tyre mund të pengohen edhe më tutje me anë të veprimeve për pastrim të parave me anë të transaksioneve ndërkombëtare, me persona që përdorin transfertat ndërkombëtare apo edhe në disa raste me hapjen e kompanive të quajtura “*kompani off-shore*.”⁸⁷ Prandaj, hetimet duhet të përfshijnë edhe bashkëpunimin jashtë Kosovës, gjë që paraqet një sfidë për Policinë e Kosovës.⁸⁸ Pasi që Kosova nuk është anëtare e OKB-së, ajo është e kufizuar në ushtrimin e rolit të saj për të marrë pjesë në organet rajonale ose ndërkombëtare.⁸⁹ Përveç palëvizshmërisë ndërkufitare dhe bashkëpunimit të kufizuar ndërkombëtar, Policia e Kosovës vazhdon të sfidohet edhe nga mungesa e kapaciteteve dhe ekspertizës.

Për shembull, Drejtoria kundër Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit ka 14 hetues policor, ndërsa njësia për hetime financiare dhe pastrim të parave ka vetëm 5 hetues.⁹⁰ Njësi të tjera të policisë mund të kryejnë hetime që ndërlidhen me pastrimin e parave, por të cilat mbesin pjesë e hetimeve penale. Pos këtyre mangësive, Policia e Kosovës është e sfiduar edhe me rastet e ndërhyrjeve politike.⁹¹ Duke pasur raste kur palët nga radhët politike të cilave iu është kërkuar që të raportojnë financat e tyre pranë Njësisë së Inteligjencës Financiare të Kosovës dhe të cilët nuk e kanë bërë një gjë të tillë, Policia e Kosovës deri më tani nuk ka ndërmarrë asnjë veprim në lidhje me këtë çështje. Pasi që policia vazhdon të jetë një ndër hallkat kryesore të hetimit në Kosovë, strukturat policore duhet të përforcohen në mënyrë që të lirohen nga çdo lloj ndërhyrjeje të mundshme politike. Gjatë vitit 2014, Njësia Financiare e Inteligjencës së Kosovës ka referuar shumicën e raporteve të inteligjencës tek

⁸⁶Komunikim me e-mail në mes të KIPRED dhe Policisë së Kosovës – Zyra për Marrëdhënie me Publikun , Shkurt 2016.

⁸⁷ Termi “*offshore*” përdoret për të përshkruar bankat e huaja, korporatat, investimet dhe depozitat e huaja. Një kompani mundet me qëllim që të bëhet komani off-shore me qëllim që t’i ik taksave dhe të gëzojë rregullat e lira. Institucionet financiare *off-shore* mund të përdoren për qëllime të liga siç janë pastrimi i parave, dhe evazioni tatimor. Shih për shembull, <http://www.investopedia.com/terms/o/offshore.asp>

⁸⁸ Komunikim me e-mail në mes të KIPRED dhe Policisë së Kosovës – Zyra për Marrëdhënie me Publikun, 10 shkurt 2016.

⁸⁹ Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara, Baza e të Dhënave Nacionale f.249.

⁹⁰ Komunikim me e-mail në mes të KIPRED dhe Policisë së Kosovës – Zyra për Marrëdhënie me Publikun 10 shkurt 2016..

⁹¹ PECK Raporti i Vlerësimit 2014, pg.15.

Policia e Kosovës, me fjalë të tjera 27 raporte apo 46% të tyre.⁹² Informacioni i parashtruar nga NJIF nuk ka qenë e dobishme për Policinë e Kosovës, pasi që ka pasur vetëm 2 kallëzime penale kundër gjashtë personave të parashtruar në vitin 2014 në lidhje me pastrimin e parave.⁹³ Bashkëpunimi në hetimin dhe kapjen e aktiviteteve të pastrimit të parave në mes të NJIF dhe Policisë së Kosovës mbetet thelbësor në luftën efektive kundër këtij krimi mjaft kompleks.

Njësia për Inteligjencë Financiare e Kosovës është relativisht e re në përvojën e saj me një mandat i cili iu ka transferuar plotësisht nga EULEX-i vetëm në vitin 2012.⁹⁴ Është mandatare për të kërkaur, pranuar dhe shpërndarë informacion nga autoritetet kompetente, dhe duhet të zbulojë informacion në lidhje me pastrimin e mundshëm të parave dhe financimin e akteve të terrorizmit.⁹⁵ NJFI punon me 18 anëtarë të personelit dhe dy zyrtarë ndërlidhës, njëri me Doganat e Kosovës dhe një me Policinë e Kosovës. NJIF është mbështetur gjithashtu edhe nga katër (4) zyrtarë të EULEX-it, megjithatë pas ristrukturimit që EULEX-i ka pësuar në qershor të vitit 2014, asnjë zyrtar i EULEX-it nuk ka mbetur në këtë njësi.⁹⁶ Largimi i tyre ka reduktuar në masë substanciale burimet njerëzore brenda NJIF -së. deri në fund të vitit 2017 NJIF planifikon që të rrisë numrin e stafit edhe me 6 anëtarë të tjerë.⁹⁷ Për sa i përket rolit të rëndësishëm të njësisë në luftimin e pastrimit të parave do të jetë e nevojshme që QK të pajis këtë institucion me burimet e nevojshme njerëzore në mënyrë që të përmbush mandatin e vetë.

Njësia kryesisht monitoron fenomenin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit nëpërmjet analizës së Raporteve të Transaksioneve Dyshimta (RTD) dhe Raportet për Transaksionet e Gatshme (kesh) (RTG). Transaksionet e dyshimta janë raportuar në NJIF kryesisht nga sektori bankar dhe agjencive të tjera të dërgesave të parave.⁹⁸ Entitete të tjera të raportimit, prej të cilave është kërkuar që të raportojnë në NJFI, në pajtim me Ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit⁹⁹, janë avokatët, kontabilistët dhe auditorët, kazinotë dhe lojërat e fatit, partitë politike dhe kompanitë e ndërtimit. Megjithatë, këto subjekte nuk vazhdojnë të raportojnë tek

⁹² 21 raste të inteligjencës apo 36% e tyre janë referuar në Administratën Tatimore të Kosovës, një (1) raport është transferuar në PSRK, dy (2) janë transferuar në EULEX dhe dy (2) janë transferuar në Doganat e Kosovës, ndërsa gjashtë (6) prej tyre janë referuar në NJIF. Shiko Raportin Vjetor të NJIF 2014, f.29.

⁹³ Komunikim me e-mail në mes të KIPRED dhe Policisë së Kosovës – Zyra për Marrëdhënie me Publikun , shkurt 2016.

⁹⁴ Shiko Raportin Vjetor të NJIF 2014, faqe 8, i disponueshëm tek <http://fiu.rks-gov.net/wp-content/uploads/2014/10/Annual-Report-FIU-K-2014.pdf> . Gjithashtu shiko Ligjin Nr. 04/L-148 mbi Ratifikimin e Marrëveshjes së Ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit. I disponueshëm tek http://www.mfa-ks.net/repository/docs/Ligji_per_ratifikimin_e_marreveshjes_KS-BE-Eulex_%28anglisht%29-1.pdf

⁹⁵ Drejtohet nga dy organe d.m.th. Bordi Drejtues dhe Zyra e Drejtorit. Bordi sipas ligjit aktual kryesohet nga Ministri i Financave i cili ka për detyrë që të mbikëqyrë edhe të sigurojë punën e pavarur të NJIF-së. Në përputhje me ligjin ministri nuk mban asnjë fuqi ekzekutive *vis a vis* NJIF gjithashtu nuk duhet të ndërhyjë në asnjë mënyrë në rastet e NJIF që janë në proces e sipër. Drejtori udhëheq punën e NJIF-së dhe kryen detyrat e menaxhimit në baza ditore. Faqja e zyrtare e internetit e NJIF-së në linkun në vijim: <http://fiu.rks-gov.net/about/?lang=en#about>

⁹⁶ Raporti Vjetor i NJIF 2014, f.12.

⁹⁷ Komunikimi me e-mail në mes të KIPRED dhe NJIF dhe Ministrisë së Financave mars 2016.

⁹⁸ Raporti Vjetor i NJIF 2014, f.19.

⁹⁹ Shih gjithashtu nenin 24 deri 28 të Ligjit i disponueshëm në <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2010-196-eng.pdf>

NJIF.¹⁰⁰ NJIF e arsyeton këtë me mungesën e vullnetit të këtyre subjekteve për të vepruar në pajtim me Ligjin. Është shqetësues fakti duke pasur parasysh se partitë politike nuk janë duke raportuar, duke qenë se shumica e kompanive më të fuqishme të biznesit në Kosovë janë të lidhura ngushtë me partitë politike dhe vazhdojnë të fitojnë fonde në formën e tenderëve publikë. Për shembull, ka pasur një vlerësim me ç’rast është konstatuar se nga gushti i vitit 2007 deri në maj të vitit 2014 nga disa donatorë të partive politike në pushtet - subjektet e biznesit dhe pronarët - kanë fituar rreth 220 milionë euro në formën e tenderëve publikë.¹⁰¹ Mungesa e raportimit dhe burimet financiare të partive politike në vazhdimësi është duke zbehur përpjekjet për të forcuar sundimin e ligjit në Kosovë.

Pos NJIF -së, një institucion tjetër i rëndësishëm në parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parave është edhe Banka Qendrore e Kosovës. Në pajtim me Ligjin mbi Bankën Qendrore, ky institucion do të jetë ekskluzivisht përgjegjës për të licencuar, mbikëqyrur dhe rregulluar institucionet financiare.¹⁰² Fillimisht, Ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit i vitit 2010 nuk kishte paraparë asnjë mandat specifik për këtë institucion në lidhje me masat kundër pastrimit të parave.¹⁰³ Vetëm në vitin 2013, kur ligji përkatës është ndryshuar, aty u përfshi një nen shtesë duke i dhënë Bankës Qendrore kompetencën për të kryer inspektime në lidhje me respektimin e këtij ligji. Megjithatë, sipas këtij neni Banka Qendrore mbetet përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të ligjit nga ana e entitetit, i cili është nën mbikëqyrjen e tyre vetëm në ato raste kur NJIF i delegon të drejtën e mbikëqyrjes në bazë të marrëveshjes me shkrim.¹⁰⁴ Rrjedhimisht, NJIF dhe Banka Qendrore kanë nënshkruar një Memorandum të Mirëkuptimit i cili i jep Bankës Qendrore në bashkëpunim me NJIF-në që të monitorojnë dhe sigurojnë nëse vlerësimi kombëtar i riskut AML/CFT (Shpëlarja e parave/financimit të terrorizmit) kanë përputhshmëri me bankat, institucionet mikro-financiare, zyrate të këmbimit valutor dhe agjencive të tjera të transferimit të parave, si dhe sigurimeve, letrave me vlerë dhe aktivitete të tjera financiare jo-bankare.¹⁰⁵ Kështu, Banka Qendrore ka ristrukturuar kuadrin e saj mbikëqyrës dhe ka krijuar Divizionin për Parandalimin e Pastrimit të Parave, i cili i raporton drejtpërdrejt Zëvendësguvernatorit që është përgjegjës për mbikëqyrjen financiare.¹⁰⁶

d) Përpjekjet e koordinimit në luftën kundër pastrimit të parave

Lufta kundër pastrimit të parave përfshin disa pjesëtarë ku secili ka rolin e vet të mandatuar për të raportuar dhe për të luftuar veprimtaritë e mundshme të pastrimit të parave. Këto institucione janë

¹⁰⁰ Raporti Vjetor i NJIF 2014, f.19.

¹⁰¹ Organizata për Demokraci, kundër korrupsion dhe dinjitetet - Çohu, Qendra Kosovare për Gazetari Hulumtuese (QKGH), Preportr, gazetë periodike Nr.14, f.2. E disponueshme tek, http://preportr.cohu.org/repository/docs/1509-Preportr14ENG_290445_606574.pdf

¹⁰² Ligji Nr. 03/L-074 mbi Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Neni 42 ,Mbikëqyrja dhe Rregullimi i institucioneve financiare: http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L074_en.pdf

¹⁰³ Shih Ligjin Nr. 03/L-196 mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe parandalimin e financimit të terrorizmit

¹⁰⁴ Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-196 mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe parandalimin e financimit të terrorizmit

¹⁰⁵ Shih Raporti i Vlerësimit PECK, f.45, 2014.

¹⁰⁶ Po aty.

të sfiduara përbrenda me mungesën e kapaciteteve dhe ekspertizës së kufizuar në trajtimin e krimeve të pastrimit të parave, ndërsa agjencitë e zbatimit të ligjit janë ende në fazën fillestare të krijimit të mekanizmave të duhur dhe sistematik për bashkëpunim dhe shkëmbim të informacionit ndërmjet agjencive. Marrja e informacioneve nga institucione të ndryshme të mandatuara për të raportuar në strukturat e inteligjencës financiare ka kufizuar edhe hetimit, ngritjen e aktakuzave dhe shpalljen e dënimeve në rastet e pastrimit të parave.¹⁰⁷ Sistemi i përbashkët bazës së të dhënave të institucioneve të sundimit të ligjit që do të përmirësoj menaxhimin e përgjithshëm të dhënave statistikore, i cili vazhdon të jetë jofunksional. Ndër sfidat e mbetura janë edhe mungesa e të dhënave të besueshme mbi rastet e pastrimit të parave, si dhe të dhënat mbi dënimet dhe aktgjykimet e formës së prerë të ekzekutuara nga gjykatat.¹⁰⁸

Në mënyrë që të përmirësohet bashkëpunimi ndër-institucional, në vitin 2014 janë krijuar disa mekanizma të përbashkët për shkëmbimin e informacioneve në mes të agjencive të cilat punojnë në fushën e krimeve financiare. Kështu është arritur një bashkëpunim në mes të NJIF, Prokurorisë së Shtetit, Policisë së Kosovës, Doganave të Kosovës dhe Administratës Tatimore, me qëllim të shkëmbimit të informacionit, të vlerësohet analiza e rrezikut dhe bashkëpunimit.¹⁰⁹ Një tjetër marrëveshje bashkëpunimi është nënshkruar në nëntor të vitit 2014 në mes të NJIF dhe Agjencisë së Regjistrimit Civil (ARC).¹¹⁰ Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është që të arrihet përmirësimi në bashkëpunimin në mes të këtyre dy institucioneve me qëllim të rritjes së parandalimit të pastrimit të parave, duke siguruar shkëmbim të informacionit nëpërmjet qasjes në bazën e të dhënave.¹¹¹ Koordinimi dhe bashkëpunimi në mes të institucioneve të mandatuara për luftimin e krimeve të pastrimit të parave vazhdon të ngelur prapa dhe ajo që është arrirë në marrëveshjen me shkrim ka gjetur zbatim të dobët.

NJIF shkëmben informacion në lidhje me pastrimin e parave kryesisht nëpërmjet sistemin elektronik të njohur si goAML (Sistemi elektronik i menaxhimit të të dhënave).¹¹² Format e raportimit të sistemit goAML lejojnë që entitet të raportojnë analizat e tyre me anë të tekstit narrativ, duke bashkëngjitur çfarëdolloj dokumenti përcjellës, në rastet kur entitet duan të ofrojnë informacione për të mbështetur dyshimet e tyre.¹¹³ Megjithatë, NJIF në shumicën e rasteve është e detyruar të kërkojë informacion shtesë nga subjektet raportuese. Përveç kësaj, qasja e NJIF-së në baza të ndryshme të të dhënave nuk është plotësisht e kënaqshme, duke ndikuar negativisht në funksionin analitik të njësisë.¹¹⁴ Si pasojë, të dyja edhe NJIF edhe institucionet financiare mbesin të mbingarkuara pasi që

¹⁰⁷ Shih Raporti i Vlerësimit PECK, f.15.

¹⁰⁸ Raporti Vjetor i NJIF 2014, f.7.

¹⁰⁹ Raporti Vjetor i NJIF 2014, f. 31.

¹¹⁰ Po aty.

¹¹¹ Raporti Vjetor i NJIF 2014, f.47.

¹¹² Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogë dhe Krim (UNODC), sistemi standard i softuerit i disponueshëm në Njësinë e Inteligjencës së Financave kundër financimit të terrorizimit dhe pastrimit të parave.

¹¹³ Shih Raporti i Vlerësimit PECK, f.105.

¹¹⁴ Shih Raporti i Vlerësimit PECK, f.14.

ato janë të detyruara që të ndajnë mjete shtesë për t'iu përgjigjur kërkesave të ndryshme, në vend se të fokusohen në rritjen e cilësisë së raporteve të paraqitura në NJIF.¹¹⁵

Cilësia e dobët e raportimit të subjekteve raportuese të NJIF është vështirësuar edhe më tej nga mungesa totale e reagimeve nga ana e NJIF-së kundrejt subjekteve raportuese, lidhur me rezultatit e hetimeve të rasteve të veçanta. Vetë NJIF-ja përballet me të njëjtat probleme si në gjerësinë ashtu edhe në cilësinë e reagimeve që merr në lidhje me rezultatet e raporteve të paraqitura pranë Prokurorisë së Shtetit dhe Policisë së Kosovës, të cilat janë shumë të ulëta dhe josistematike.¹¹⁶ Përveç kësaj, puna e përbashkët institucionale në trajtimin e rasteve të pastrimit të parave nuk është e mjaftueshme. Për shembull, në vitin 2014, NJIF ka realizuar vetëm dy (2) projekte të përbashkëta të analizave/hetimeve me institucionet e tjera të mandatuara.¹¹⁷ Duke pasur parasysh kompleksitetin e krimeve të pastrimit të parave dhe ekspertizën e kufizuar në trajtimin e këtij fenomeni, institucionet e Kosovës duhet të punojnë në rritjen e mëtejme të përpjekjeve të tyre të përbashkëta në mënyrë që të kenë progres në hetimin dhe ndjekjen e krimeve të pastrimit të parave.

Kapacitetet aktuale të pamjaftueshme të NJIF-së e kanë nënvlerësuar bashkëpunimin e NJIF-së me autoritetet vendore, qasjen e informacionit dhe rritjen e cilësisë së analizave nga njëra. ¹¹⁸ Për shembull, numri i raporteve të inteligjencës që NJIF ka shpërndarë në institucionet kombëtare dhe homologët e tyre ndërkombëtarë, ka rënë nga 74 raportet të shpërndara në vitin 2013 në 59 raporte të shpërndara në vitin 2014. ¹¹⁹ Nga raportet e përgjithshme të referuara tek institucionet përkatëse në vitin 2014, vetëm një (1) raporti është dorëzuar në Prokurorinë Speciale të Kosovës dhe 27 raporte janë referuar në Policinë e Kosovës.¹²⁰

Në përfundim, reagimi i dobët nga ana e institucioneve të mandatuara ka vazhduar edhe përkundër trajnimeve të rëndësishme që janë ofruar për rritjen e ekspertizës financiare në hetimin, ndjekjen dhe dënimin e krimeve të pastrimit të parave. Megjithatë, ndryshimet e shpeshta në legjislacion kanë ndikuar që të krijohen vështirësi edhe për prokurorinë dhe gjykatat në ndjekjen e hapave të ndryshimeve ligjore.¹²¹ Në ndërkohë janë ofruar edhe disa trajnime për Doganat e Kosovës dhe NJIF në lidhje me aspektet e pastrimit të parave dhe analizave financiare.¹²² Në vitin 2015 Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGJK) ka organizuar 15 trajnime për gjyqtarët dhe prokurorët në lidhje me temat mbi korrupsionin, krimin e organizuar, pastrimin e parave dhe krime të tjera të ngjashme financiare.¹²³ Të paktën shtatë (7) sesione trajnimi janë paraparë të mbahen në vitin 2016.¹²⁴

¹¹⁵ Po aty.

¹¹⁶ Raporti i Vlerësimit PECK, f.14.

¹¹⁷ Raporti Vjetor i NJIF 2014, f..27.

¹¹⁸ Raporti i Vlerësimit PECK 2014, f.12.

¹¹⁹ Raporti Vjetor i NJIF 2014, f..28.

¹²⁰ 21 raste të inteligjencës janë referuar në Administratën Tatimore të Kosovës, (2) janë transferuar në EULEX dhe dy (2) janë transferuar në Doganat e Kosovës, ndërsa gjashtë (6) prej tyre janë referuar në NJIF. Shiko Raportin Vjetor të NJIF 2014, f 29.

¹²¹ KIPRED – intervistë me zyrtarë nga Instituti Gjyqësor i Kosovës, Janar 2016 Prishtinë.

¹²² Pjesë e trajnimeve kanë qenë edhe palë të tjera të interesuara si hetues nga Policia e Kosovës, prokurorë, gjyqtarë, inspektorë tatimorë dhe bankarë. Shiko Raportin e Vlerësimit PECK, f.117.

¹²³ Deklarata e zyrtarit të Institutit Gjyqësor të Kosovës në tryezën e rumbullakët të organizuar nga KIPRED dhe Syri i Vizionit, 31 mars 2016 në Prishtinë.

Përkundër kësaj, niveli i njohurive në ofrimin e trajnimeve mbetet i kufizuar në lidhje me temat që përfshijnë pastrimin e parave dhe shpeshherë trajnuesit ndajnë të njëjtin nivel të njohurive me gjyqtarët dhe prokurorët.¹²⁵ Për këtë arsye, numri i trajnimeve të ofruara nga Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës në bashkëpunim me donatorët është rritur.¹²⁶ Është e nevojshme që të krijohen plane për trajnime specifike në bashkëpunim me të gjitha palët përgjegjëse. Për më tepër shpeshësia e trajnimeve të specializuara për personelin e sundimit të ligjit dhe prokurorët duhet të rritet, ndërsa niveli i njohurive të trajnuesve duhet t'i përshtatet nevojave të institucioneve në trajtimin e krimeve të pastrimit të parave.

V. Përfundim dhe Rekomandime

Në përfundim, Kosova ka treguar progres të kufizuar në luftën e saj kundër pastrimit të parave, përkundër kornizës strategjike dhe legjislativë tashmë të krijuar. Përbërësi kryesor, që është gatishmëria politike dhe institucionale duket se mungon, ndërsa Kosova vazhdon të kushtëzohet nga ana e BE-së për të treguar rezultate në luftimin e këtij fenomeni. Për këtë arsye, institucionet e sundimit të ligjit janë të nxitura nga BE-ja që të forcojnë në masë të madhe zotimin e tyre për të ndjekur rastet e pastrimit të parave dhe të ndërmarrin masat e duhura në mënyrë që të rritet numri i lëndëve të përfunduara me aktakuza, dënime dhe ekzekutim të aktgjykimeve të formës së prerë. Për më tepër, anëtarësia e kufizuar e Kosovës në organet dhe forumet ndërkombëtare për çështje që lidhen me pastrimin e parave gjithashtu e pengon hetimin adekuat të këtyre rasteve.

Në ndërkohë, rregulli kryesor i institucioneve të sundimit të ligjit të mandatuara për luftimin e aktiviteteve të pastrimit të parave, vazhdojnë të përballen me mungesë të kapacitetet e mjaftueshme institucionale, mungesë të bashkëpunimit dhe me ndërhyrjet e mundshme politike. Sfidat mbeten kryesisht në histori të suksesshme të hetimeve, aktakuzave dhe dënimeve përfundimtare në lidhje me krimet e pastrimit të parave. Me një proporcion prej 1 personi (rasti) të shpallur fajtor për pastrim parash nga ana e gjykatave të Kosovës dhe 83% të rasteve të mbetura të pazgjidhura dhe të bartura në vitin 2016 nga Zyra e Prokurorisë Speciale të Kosovës për vitin 2015, Kosova duket se ka mbetur shumë mbrapa në krijimin e të dhënave efikase në lidhje me aktakuzat dhe dënimet.

Institucionet e Kosovës të sundimit të ligjit kanë nevojë të rrisin përpjekjet e tyre të përgjithshme në përmirësimin e të dhënave të tyre në lidhje me luftimin e krimeve të pastrimit të parave. Për më tepër, lidhjet në mes të politikës dhe aktiviteteve të dyshimta të biznesit, përfshirë ato nga fusha e ndërtimitarisë, duhet të sigurohet se janë duke u hetuar dhe ndjekur penalisht. Duke qenë se krimi i i pastrimit të parave shpeshherë është i ndërlidhur me krime të tjera, institucionet e Kosovës të sundimit të ligjit kanë nevojë të atakojnë aktivitete që merren me pastrimin e parave, përfshirë edhe korrupsionin e profilin të lartë, ekonominë jo formale dhe evazionin tatimor. Për më tepër pasuria vjetore e raportuar nga ana e zyrtarëve publikë paraqet pasuri të pashpjegueshme krahasuar me të

¹²⁴ Po aty.

¹²⁵ KIPRED – intervistë me Prokurorin e Shtetit, janar 2016

¹²⁶ KIPRED – intervistë me zyrtarë nga IGJK, janar 2016.

ardhurat e tyre vjetore, dhe një gjë e tillë mund të shërbejë si një trase e sigurt për të kryer hetimet e mundshme ndaj krimit të pastrimit të parave dhe çështjeve që lidhen me korrupsionin. Pa i dhënë fund pandëshkueshmërisë në Kosovë kundrejt zyrtarëve publikë të profilit të lartë nëpërmjet një qasje jo-selektive nga ana e gjykatave, Kosova nuk do të jetë në gjendje që të ec përpara në krijimin e një shteti të qëndrueshëm dhe funksional për qytetarët e saj.

Në mënyrë që të përmirësohet lufta kundër krimeve të pastrimit të parave, KIPRED dhe SiV propozojnë për institucionet e Kosovës që të zbatojnë rekomandimet në vijim:

- Projektligji i ri kundër pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit duhet të parasheh zvogëlim të raportimit nga ana e OJQ-ve, ashtu siç qëndron në projektligjin e ri, duhet të hiqet pasi që një gjë e tillë mund të paraqes ndërhyrje në punën e pavarur të sektorit të OJQ-ve. Më tej, me një zhvillim të duhur në lidhje me kërkesat për raportim për sektorin e OJQ-ve në përputhje me rekomandimet, të 8 institucionet e Kosovës FTAF duhet të punojnë edhe në miratimin e Ligjit të ri mbi Lirinë Fetare në mënyrë që të mbikëqyrët çdo financim i dyshimtë që vije nga jashtë dhe brenda Kosovës, pasi organizatat humanitare dhe shoqatat me karakter fetar nuk konsiderohen si OJQ, duke e lënë këtë sektor të veçantë jashtë çdo kërkesë për të raportuar;
- Përveç Vlerësimit të Rrezikut Kombëtar kundër pastrimit të parave, institucionet e Kosovës, në bashkëpunim me palë e tjera të interesuara, siç është shoqëria civile, duhet të zhvillojë një vlerësim të rrezikut sektorial, duke i dhënë prioritet sektorëve tashmë të njohur me rrezik të lartë, siç është sektori i ndërtimitarisë. Vlerësimet e rrezikut duhet pastaj të përkthehen në plane veprimi me caqe dhe përfundime të caktuara;
- Duhet të rritet edhe më tej koordinimi në mes të institucioneve të sundimit të ligjit të mandatuara për luftimin e rasteve të pastrimit të parave. Njësia e Inteligjencës Financiare në veçanti duhet të përforcojë komunikimin dhe bashkëpunimin me entitetet raportuese dhe organet e thera të sundimit të ligjit, duke përfshirë këtu policinë dhe prokurorinë. Të gjitha palët e interesuara duhet të rrisin përpjekjet e tyre të përbashkëta dhe të ofrojnë vlerësimet e tyre ndaj secilit institucion të përfshirë në trajtimin e rasteve të pastrimit të parave, duke zhvilluar në këtë mënyrë takime të rregullta koordinimi për secilin rast veç e veç;
- Të gjitha palët e interesuara duhet të rrisin kapacitetet hetuese, në mënyrë të veçantë prokuroria speciale, departamenti i krimeve të rënda të gjykatave dhe agjencitë për zbatimin e ligjit. Në veçanti NJIF-ja duhet që urgjentisht të plotësojë nevojat e burimeve njerëzore, të cilat janë zvogëluar si rezultat i largimit të zyrtarëve të EULEX-it. Përveç kësaj, të gjitha mangësitë në lidhje me hetimit dhe ndjekjen penale në Kosovë duhet t'i drejtohen qeverisë, duke bërë rishikime të rregullta strategjike dhe buxhetore, në mënyrë që institucionet e mandatuara të jenë në gjendje të përmbushin mandatin e tyre në luftën kundër pastrimit të parave dhe të rasteve të tjera të krimit të organizuar;

- Pasi që pastrimi i parave është relativisht fushë e re për institucionet e Kosovës dhe duke pasur parasysh të dhënat e dobët të aktakuzave dhe dënimeve, duhet të rriten edhe më tej kapacitetet profesionale të institucioneve të mandatuara. NJJF, Policia e Kosovës, Prokuroria e Shtetit dhe institucionet e tjera duhet të vazhdojë të zhvillojë dhe të marrin pjesë në trajnime të specializuara në këtë fushë, duke rritur shpeshhtësinë e trajnimeve të tilla nëse një gjë e tillë konsiderohet e nevojshme;
- Qeveria e Kosovës duhet të demonstrojë një gatishmëri në krijimin e parakushteve të nevojshme për institucionet e Kosovës të sundimit të ligjit për luftën kundër pastrimit të parave, duke siguruar që puna e tyre të jetë e lirë nga ndërhyrjet politike. Për më tepër, personave të cilët raportojnë aktivitete të mundshme në lidhje me pastrimin e parave duhet t'u ofrohet mbrojtje adekuate institucionale dhe motivim duke u dhënë fund praktikave aktuale të suspendimit apo masave të tjera;
- Përfundimisht, institucionet e Kosovës të sundimit të ligjit duhet të atakojnë aktivitete që paraprijnë pastrimin e parave, përfshirë këtu korrupsionin e profilit të lartë, ekonominë jo formale dhe evazionin tatimor. Përveç kësaj pasuria e pashpjegueshme vjetore e raportuar e zyrtarëve publikë krahasuar me të hyrat e tyre vjetore duhet të shërbejë si një trase e dobishme për kryerjen e hetimeve të pastrimit të parave dhe çështjeve që lidhen me korrupsionin.

VI. Shtojca

Tabela 1.3: Gjendja e veprave penale të lidhura me Pastrimin e Parave në PSRK, për vitet 2014 dhe 2015										
Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK)	Gjithsej lëndë në punë	Gjithsej persona me lëndë në punë	Lëndë të zgjidhura	% e lëndëve të zgjidhura	Numri i personave, të cilëve iu janë zgjidhur lëndët	% e personave, të cilëve iu janë zgjidhur lëndët	Lëndë të pazgjidhura	% e lëndëve të pazgjidhura	Numri i personave, të cilëve nuk iu janë zgjidhur lëndët	% e personave, të cilëve nuk iu janë zgjidhur lëndët
Viti 2014	42	117	14	33%	37	32%	28	67%	80	68%
Viti 2015	36	106	6	17%	14	13%	30	83%	92	87%

Burimi: Këshilli Prokurorial i Kosovës

Tabela 1.4: Parashtruesit e kallëzimeve penale për Pastrim të Parave, periudha 2014-2015								
Sipas parashtruesit të kallëzimit penal	2014				2015			
	Gjithsej		%		Gjithsej		%	
	R	P	R	P	R	P	R	P
Agjencia Kundër Korrupsionit	1	3	9%	12%				
Dogana e Kosovës	1	1	9%	4%				
EULEX-i								
E pranuar në kompetencë	2	2	18%	8%				
Njësia për Inteligjencë Financiare	1	2	9%	8%	1	2	11%	7%
Policia e Kosovës	5	14	45%	56%	7	21	78%	78%
Prokurori me vetëiniciativë					1	4	11%	15%
Të tjera (qytetari, ...)	1	3	9%	12%				
Gjithsej	11	25			9	27		

Burimi: Këshilli Prokurorial i Kosovës

Tabela 1.5: Veprimet e prokurorëve të ndërmarra gjatë procedurës për zgjidhjen e rasteve të Pastrimit të Parave, periudha 2014-2015								
Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK)	Numri i kërkesave për informata shitesë	Numri i urdhërësave për masa të fshehta	Numri i aktvendimeve për fillimin e hetimeve	Numri i kërkesave për caktimin e paraburgimit	Numri i kërkesave të aprovuara nga Gjykata	Numri i aktvendimeve për zgjerimin e hetimeve	Pezullimi i procedurës	Rifillimi i procedurës pas pezullimit të hetimeve
2014	34	9	27	2	1	3	6	1
2015			18	1	1	2	9	

Burimi: Këshilli Prokurorial i Kosovës